



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa

02 No. 188-19
08.10.2019



Referenca : 626-19-018-1-2-1

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në bazë të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik A01, neni 18, dhe neni 39 në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, neni 8 paragrafi 8.1 dhe pika 8.1.1 bie këtë:

V E N D I M

I

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “COMET” SH.P.K. e parashtruar me datën 07.10.2019 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-19-3455-1-2-1 nr. të brendshëm 626-19-018-1-2-1 dhe titull: “Furnizimi me fshesa për pastrim dhe vegla pune”

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik “COMET” SH.P.K. me datë 07.10.2019 përmes platformës elektronike ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues Komuna e Mamushës.

Si Autoritet Kontraktues, pas pranimit të kërkesës brenda afatit ligjor kemi filluar shqyrtimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga O.E. “COMET” SH.P.K. i cili në deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet pretendon se janë shkelur dispozitat ligjore të LPP-s të parashikuara në nenet : 1, 7, 59, 60, 72, shkelje të nenit 39.8 të RrUOPP-së si dhe shkelja e vendimit të OSHP-së.

Si autoritet kontraktues në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë i kemi paraparë kërkesat të cilat duhet ti plotësojnë Operatorët Ekonomik për të qenë të përgjegjshëm, andaj vlerësimi është bërë në bazë të legjislacionit të LPP-s si dhe në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Pretendimi i O.E. ankues se e kemi shkelur vendimin e OSHP-s është i pa bazuar, pasi që ne sapo kemi marrë vendimin nga OSHP, kemi marrë vendim për anulimin e dhënies së kontratës dhe lëndën e kemi kthyer në ri-vlerësim sikur është paraparë në diasozitivin e vendimit të OSHP-së PSH nr. 491/19. Edhe pretendimi se OSHP ka pranuar kërkesën e O.E. si të bazuar nuk qëndron pasi që Paneli Shqyrtues ka konstatuar se pretendimi i O.E. është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i O.E. që ne nuk kemi siguruar shfrytëzimin e mjeteve në mënyrë të drejtë dhe efikase, duke shpenzuar mjete financiare në mënyrë jo të drejtë dhe se është shkelur neni 1 i LPP-s nuk qëndron, pasi që ne si Autoritet Kontraktues e kemi zhvilluar procedurën në fjalë duke u bazuar në dispozitat e nenit 1 si dhe në dispozitat tjera të LPP-s në mënyrë të hapur dhe transparente. Pra pretendimi nuk qëndron pasi që në tërësi janë respektuar dispozitat e këtij neni. Do të vinte në shprehje shkelja e këtij neni po që se O.E. ankues do të kishte dorëzuar tender të përgjegjshëm, në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, mirëpo me qenë se nuk i ka plotësuar kërkesat në dosje të tenderit si dhe specifikat teknike është konsideruar si O.E. i pa përgjegjshëm.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-s, edhe ky pretendim nuk qëndron pasi që procedura është zhvilluar në mënyrë të hapur dhe transparente. Vlerësimi është bërë në mënyrë profesionale duke i trajtuar të gjithë O.E. në mënyrë të barabartë. Nga O.E. ankues me datën 04.07.2019 është kërkuar sqarim në lidhje me specifikat teknike mirëpo i njëjti ka ofruar artikuj të cilët nuk i kanë plotësuar specifikat minimale të kërkuara në dosje të tenderit dhe në përshkrimin e çmimit. Në dosje të tenderit në nenin 22 është kërkuar artikulli Thithëse elektrike 2200 watt për përdorim industrial, mirëpo O.E ka ofruar thithëse elektrike me dy motor ku çdo njeri prej motorëve posedon fuqi 1200 W, por qe fuqia thithëse nuk është 2400 W sikur është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në specifikacionin teknik . Edhe vetë O.E. e ka cekur se fuqia thithëse nënkupton fuqinë e Elektromotorit, por që në këtë rast pajisja të cilën e ka ofruar O.E. ankues nuk punon me fuqi 2200 Watt për thithjen e pluhurave, por njëri motor ka fuqi thithëse 1200 wat ndërsa motori tjetër është për kryerjen e operacioneve tjera të cilat nuk kanë rëndësi për A.K. Pasi e kemi kthyer lëndën në rivlerësim me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe profesional, kemi caktuar një komision të ri, ndër të cilët kemi angazhuar edhe një inxhinier të elektroteknikës. Edhe komisioni tjetër përkatësisht inxhinieri i elektroteknikës si ekspert ka konstatuar që pajisja të cilën e ka dorëzuar O.E. ankues nuk i plotëson specifikat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

O.E. ankues me rastin dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim ka dorëzuar disa foto të cilat nuk janë të njëjta me foton të cilën e ka dorëzuar me rastin e kërkesës tonë për sqarim, sepse shumë qartë shihet se O.E. në sqarim e ka dorëzuar foton e thithëses të prodhuar nga prodhuesi “star”

modeli 602-wdm, ndërsa me rastin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të datës 07.10.2019 me qëllim të futjes në lajthim të Autoritetit Kontraktues ka paraqitur foto të firmës “karcher” Wd2 Andaj me qenë se nuk janë plotësuar specifikat teknike është konsideruar se O.E. është i pa përgjegjshëm.

Edhe pretendimi se është shkelur neni 59 është i pa bazë dhe i pa qëndrueshëm, pasi që në dispozitat e këtij neni në paragrafin 4 është paraparë që Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pasi që në dosje të tenderit në nenin 3.1 të FTD-s është paraparë që Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (**Të plotësohet, nënshkruhet dhe vuloset aneksi nr.2 i kësaj dosje të tenderit**);

Pra në bazë të kësaj kërkesë është shumë e qartë se Operatorët Ekonomik kanë qenë të obliguar që të dorëzojnë deklaratën për specifika teknike si dhe ti plotësojnë specifikat minimale të kërkuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Në nenin 41 të RrUOPP-s në pikën 41.3 tek parimet kryesore të procedurës së vlerësimit shprehimisht është paraparë që:

- 1. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara**
- 2. Tenderët duhet të jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).**
- 3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara**

Sikur kemi cekur më lartë, deklarata për specifikacion teknik është kërkesë formale administrative dhe është e njëjtë me kërkesat tjera formale administrative sikur është afati i liferimit, afati i fundit për dorëzimin e tenderit, deklaratat në rast të dorëzimit të tenderit nga ana ndonjë grupi etj. dhe mos plotësimi i këtyre kërkesave e bën të pa përgjegjshëm operatorin ekonomik dhe qon në eliminimin e tijë.

Në nenin 60 në paragrafin 1. është paraparë që Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

- 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;
- 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas paragrafit 3. të nenit 52 te këtij ligji.

Ne si Autoritet Kontraktues kemi specifikuar qartë në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë se kontrata do ti jepet Operatorit Ekonomik i cili dorëzon: tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, andaj me qenë se ju nuk keni dorëzuar tender të përgjegjshëm për arsyet e cekura më lartë, është vendosur që të shpërblehet me kontratë O.E. i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Pra edhe pretendimi që është shkelur neni 60 nga ana jonë nuk qëndron.

Sa i përket pretendimit të O.E. se kemi shkelur dispozitat e nenit 72 të LPP-s konsiderojmë që

edhe ky pretendim është i pa bazë, pasi që ne kemi kërkuar informacione shtesë nga të gjithë pjesëmarrësit në këtë procedurë të prokurimit dhe kemi marrë vetëm informatat të cilat janë të lejuara sipas nenit 72 dhe 59 të LPP-s.

Sa i përket pretendimit se O.E. i shpërblyer me kontratë nuk i ka plotësuar specifikat teknike konsiderojmë që edhe ky pretendim nuk është i bazuar pasi që ka dorëzuar fotografitë me specifika teknike për pajisjet elektrike sikur është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ne nuk kemi kërkuar që pajisja të jetë e ndonjë marke të caktuar andaj dërgimi i fotos me specifika të cilat përshtaten me specifikat e kërkuara në dosje të tenderit ka qenë i mjaftueshëm.

Deklarata për specifikacion teknik është kërkesë administrative e paraparë në nenin 3.1 të dosjes së tenderit e cila obligon O.E. që të deklaroj se do ti përmbahet specifikacioneve teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Në nenin 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit në paraqitje tabelore, shprehimisht është cekur se OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në rast kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene në përputhje me specifikimin e kërkuar). Në të kundërtën është paraparë që të refuzohet tenderi pa kërkuar informacione shtesë. Pra ne i jemi përmbajtur pikërisht dispozitave të këtij neni dhe nuk i kemi shkelur dispozitat në fjalë sikur ka pretenduar O.E. në kërkesën për rishqyrtim.

Në tenderin në fjalë ka pasur artikuj të cilët nuk mund të specifikohen detajisht dhe për të njëjtit nuk është kërkuar katalogu, pra në këtë rast deklarata për specifikacion teknik do ti mbulonte të gjithë artikujt e kërkuar të cilën nuk kanë mundur të specifikohen për shkak të natyrës së tyre p.sh. veglat e punës.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë si dhe në dispozitat në fuqi të Legjislacionit të Prokurimit Publik u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me dt. 08.10.2019

Në M a m u s h ë

Gazmend Gashi
Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues.